



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0105

OSHP: 2025/0106

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Kryesuese, Isa Hasani dhe KimeteGashi-Brajshori-Anëtar të Panelit Shqyrtues duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “CONEX” L.L.C., si dhe OE “BM Group” SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, të “MINISTRIA E SHËNDETËSISË”, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i objektit të ri për Institutin Special në Shtime” me numër të prokurimit 206-24-187-5-1-1, me 24/04/2025, mori:

Vendim

1. Aprovohen, si pjesërishtë të bazuara ankesa e OE “CONEX” L.L.C., me nr. 2025/0105, e datës 10/02/2025, dhe ankesa e OE “BM Group” SH.P.K., me nr. 2025/0106, e datës 10/02/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i objektit të ri për Institutin Special në Shtime” me numër të prokurimit 206-24-187-5-1-1.

2. Mbetet në fuqi B58 Njoftim mbi vendimin e AK-së sipas dispozitivit I të këtij vendimi.

3. Meqenëse ankesat e OE-ve ankues aprovohet si pjesërishtë e bazuar, “CONEX” L.L.C., si dhe ankesa e OE “BM Group” SH.P.K., bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 17.10.2024, “MINISTRIA E SHËNDETËSISË” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Ndërtimi i objektit të ri për Institutin Special ne Shtime” me nr. të prokurimit: 206-24-187-5-1-1. Ndërsa me datën 22.01.2025 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës: pune, vlera e parashikuar e kontratës: 6,800,619.76 €.

Me 27.01.2025, OE “CONEX” L.L.C., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 31.01.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 27.01.2025, OE “BM Group” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 31.01.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 10/02/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “CONEX” L.L.C., me nr. 2025/0105, për lidhur me aktivitetin “Ndërtimi i objektit të ri për Institutin Special ne Shtime” me nr. të prokurimit: 206-24-187-5-1-1.

Me 10/02/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “BM Group” SH.P.K., me nr. 2025/0106, për lidhur me aktivitetin “Ndërtimi i objektit të ri për Institutin Special ne Shtime” me nr. të prokurimit: 206-24-187-5-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 0105/25 dhe ankesa nr. 0106/25 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “CONEX” L.L.C., janë parashtruar si në vijim:

Me datën 17.10.2024, në procedurë të hapur është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, aktiviteti i prokurimit: Ndërtimi i objektit të ri për Institutin Special ne Shtime Me nr. prokurimit: 206-24-187-5-1-1

Me datën 18.11.2025, grupi OE parashtruesit e ankesës “Agri Construction”sh.p.k & Conex L.L.C , Pepa Group sh.p.k, ka ofertuar në aktivitetin e lartcekur të prokurimit, dhe në tërësi i ka plotësuar të gjitha kërkesat administrative dhe kualifikuese të parashtruara nga AK në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë pasi që ka paraqitur çmimin ekonomikisht më të favorshëm

Me datën 22.01.2025, AK, ka publikuar përmes B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, me të cilin e ka shpërblyer me kontratë OE: „Raf II”sh.p.k, e ku ne si GOE na ka shpallur si të eliminuar, e ku OE i shpallur është 971,564.70 euro më i shtrenjtë se oferta jonë,

Prandaj, duke qenë se nga ana e AK-së edhe gjatë procesit paraprak për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, nuk janë ndërmarrë veprime që kanë për qëllim korrigjimin e akteve dhe veprimeve të kundërligjshme që ndërlidhen me këto vendime duke na cenuar te drejtën dhe interesat tona ligjore në raport me interesin material nga kjo kontratë, andaj me datën 10.02.2025 i drejtohem OSHP-së me këtë ankesë të bazuar/mbështetur në fakte dhe prova të argumentuara për secilën shkelje të pretenduar, në mënyrë që të njëjtat të vlerësohen dhe shqyrtohen nga ekspert shqyrtues/paneli shqyrtues në mënyrë profesionale dhe meritore si dhe në pajtueshmëri me këtë ligj.

Ne vijim gjeni pretendimet ankimore të njëjta me ato të paraqitura për autoritetin kontraktues përmes kërkesës për rishqyrtim të dt. 27.01.2025

Në bazë të pikës së parë të arsytimit për diskualifikimin e ofertës tonë në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar sipas dt.22.01.2025, janë përmendur

Ky vlerësim i AK-së nuk pasqyron mënyrën të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike dhe si i tillë është në kundërshtim me kriteret e përgjegjshmërisë dhe vlerësimit të tenderëve sipas nenit 59 paragrafi 2 dhe 4 lidhur me nenin 72 të LPP, pasi që në dosjen e tenderit kemi dokumentacionin dhe të saktë

Pretendimi i parë (1). Në bazë të pikës së dytë mbi pretendimin e eliminimit sipas AK- ku ka argumentuar:

Sigurimi i ofertës është kërkuar 70,000 euro me afatin e vlefshmërisë prej 150 ditë, ndërsa OE ka ofertuar me afat e vlefshmërisë prej 120 ditë.

Arsyeja e dytë e eliminimit ka të bëjë me atë se nuk kemi ofruar sigurimin e tenderit e afat vlefshmërie prej 150 ditë por e kemi ofruar për 120 ditë. Ne para se të ofertojmë kemi kërkuar nga kompania e sigurimeve Sigkos që të na bëjnë sigurimin për 150 ditë siç është kërkuar, mirëpo kompania në fjalë ka bërë një lëshim teknik kur e ka bërë sigurimin duke e bërë për 120 ditë, ndërsa ne nuk e kemi vërejt këtë lëshim duke besuar në profesionalizmin e tyre, mirë që AK ka kërkuar të plotësoj Aneksi 4 Siguria e tenderit lidhur me këtë projekt e që ky model tregon se ofertuesi saktë me vlerën dhe ditët po oferton për ditët dhe vlerën e saktë, andaj ne si OE i kemi dërguar dosjen e tenderit kompanisë së sigurimit SIGKOS, ku kompania në fjalë e ka shtypur këtë aneks dhe ka filluar me përgatitjen e polises së sigurimit, mirëpo gjatë përgatitjes së tyre ka ndodhur një lëshimin teknik të tyre kjo kompani e ka vërtetuar edhe me dt.24.01.2025 ku e kanë sqaruar këtë çështje dhe njëkohësisht kanë marr përgjegjësinë e tyre për këtë lëshim dhe për sigurim me afat prej 150 ditëve.

Bashkangjitur keni shkresën në fjalë.

Sidoqoftë edhe në këto momente oferta jonë ka afat të vlefshmërisë së sigurimit të tenderit dhe oferta jonë është e përgjegjshme, prandaj ky lëshim në vlefshmëri është gabim teknik pa ndryshim përmbajtësor sipas nenit 59 par 4 (ii) sepse ky fakt nuk ndikon aspak në përgjegjshmërinë e ofertës dhe përbën ndonjë ndryshim materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit Neni 59.4 i LPP-së: Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, poashtu gjatë plotësimit të polises së sigurimit nga ana e kompanisë është dërguar fatura e kësaj polise me nr faturës Nr:05390/24 me vlerë 619.50 e paguar menjëherë për lëshimin e kësaj polise, e duke u bazuar tek vlera 619.50 dhe duke specifikuar kompanitë e tjera të sigurimit, se vlera 619.50euro ka qenë për 150 ditë, pasi që për 60 ditë, 90 ditë, 120ditë ka tarifa të tjera, andaj vlera e 619.50 euro e ka vërtetuar që kompania e sigurimit SIGKOS ka lëshuar një gabim të lehtë teknikë, e argumentuar dhe e vërtetuar edhe përmes emali,.

Lidhur nga e kaluara me disa vendime të OSHP-së nga procedurat e prokurimit më të hershme paneli shqyrtuesi ka pasur dhe vendosur vendime mbi devijime të tilla të paraqitura nga kompanitë e sigurimit më saktë mundëni të gjeni vendimin OSHP:2023/0688,0689,0697, lidhur me aktivitetin e prokurimit 70433736-23-6318-2-1-1, ankesë e paraqitur nga vete një Kompani e sigurimeve-Kompania e Sigurimeve EUROSIG SH.A ku sipas kësaj ankese kompania tek deshmia 3 thekson: si është e mundur që KV pranon një dokument ofertues për sigurimin nga OE Scardian J.S.C ku në atë dokument shihet që validiteti i ofertës ka qenë 30 dite ndërsa në DT është kërkuar 90 dite, andaj tek kjo ankese paneli shqyrtues me vendimin OSHP:2023/0697 12.12.2023 i ka refuzuar ankesën si të pa bazuar OE Eurosig sh.a dhe se të pika e pretenduar lidhur me këtë pike ekspertit shqyrtues ka theksuar:

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimit ankimor, operatori ekonomik Kompania e Sigurimeve Eurosig SH.A - Prishtinë më tej si parashtrues i ankesës lidhur vlefshmërinë e tenderit, OE i cili është i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij ka dorëzuar Formular për Dorëzimin e Tenderit është identifikuar se ka vlefshmëri të tenderit 90 ditë sipas kërkesë. Andaj, ky pretendim ankimor i bërë nga Kompania e Sigurimeve Eurosig SH.A - Prishtinë” për ekspertin shqyrtues është i pa bazuar. Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaroi se pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE ka deklaruar se pajtohet pjesërisht me raportin e ekspertit shqyrtues. Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se ka nevojë të mbahet seanca publike me palë dhe për këto lëndë me qëllim të sqarimit sa më në detaje paneli shqyrtues mbajti seancë më datë 01.12.2023. Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit Vlerësimi i tenderëve nuk është bërë sipas nenit 59 të LPP-së dhe nenit 60 të LPP-së.

Pretendimi i dytë (2): Lidhur me kërkesën Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka realizuar me sukses në tërësi projekte të ngjashme nga lomia e punëve në objekte të larta, në vlerë të përgjithshme jo më pak se 9 Milion Euro, gjatë periudhës së shkuar tre vjeçare nga data e Njoftimit për Kontratë. Në rast të konsorciumit, së paku 60% e projekteve kërkohet për liderin e grupit. Së paku njëri nga projektet të jetë nga objekt shëndetësorë - kontratë me vlerë të madhe e realizuar nga lideri i grupit.

OE: „Raf II”sh.p.k, ka paraqitur: Nga lista e paraqitur në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, vetëm projektet e ngjashme të realizuar në 3 vitet e fundit e plotësojnë kriterin si: Completion of Construction of a Neë Sports Center “Omnisport and Landscapingeorks me vlerë totale = 3,811,419.57 Euro Amelia – faza 2 Ndertimi I Objektit afarist me apartamente luksoze B+P+8, Prizren, me vlerë totale = 3,524,335.33 Euro.

Projektet e listuar sipas nr. rendor tek lista e projekteve si në vijim nuk pranohen sepse: Projekti nr.2 – periudha e fillimi dhe mbarimit të punëve është 10/2018-04/2021 gjë të cilën nuk e plotëson kriterin pasi që publikimi për njoftim të kontratës është 18.11.2024. Duke kalkuluar që kërkesa ka qene 3 vitet e fundit i bie që me 04/2024 ka përfundua valediteti i pranimit të punimeve, nuk e plotëson kriterin e DT-se.

Projekti nr.5 – periudha e fillimi dhe mbarimit të punëve është 12/2016-03/2021 gjë të cilën nuk e plotëson kriterin pasi që publikimi për njoftim të kontratës është 18.11.2024. Duke kalkuluar që kërkesa ka qene 3 vitet e fundit i bie që me 03/2024 ka përfundua valediteti i pranimit të punimeve, nuk e plotëson kriterin e DT-se.

Projekti nr.4 – OE ka dorëzuar kërkesë për pranim teknik në Komunën e Prizrenit me datën 16.10.2024 me etazhitet 2B+P+9+Ph që bie në kundërshtim me emërtim nga lista e projekteve dhe që njëashtu nuk posedon referencë apo pranim teknik lidhur me këtë projekt me vlerë totale = 8,390,052.31 Euro, nuk plotëson kriterin e DT-se. Pas kërkesës për sqarime është vendosur një konfirmim nga Komuna e Prizrenit e lëshuar me datë 17.01.2025 e cila konsiderohet dokument shtese dhe nga LPP nuk pranohen.

Projekti nr.6 – OE ka dorëzuar projekt në lamin e infrastrukturës rrugore(ndërtim i ulet) gjë të cilën nuk e plotëson kriterin e DT-se.

Si përfundim vlera totale e projekteve të vlefshme është $3,811,419.57 + 3,524,335.33 = 7,335,754.90$ Euro, dhe mungojnë -1,664,245.10 Euro për të plotësuar kërkesën e DT-se, po ashtu OE ka dështuar të prezantojë kriterin kryesor që është kërkuar Së paku njëri nga projektet të jetë nga objekt shëndetësorë - kontratë me vlerë të madhe e realizuar nga lideri i grupit, ky faktë është paraqitur në kërkesën për rishqyrtim të datës 27.01.2025, mirëpo ZPP-AK-me datën 31.01.2025 e as që ka marrë për bazë pikat e tilla duke theksuar:

Edhe pas kërkesës për rishqyrtim AK vazhdon përsëri me vendimet diskriminuese dhe favorizuese të OE të shpallur sipas vendimit B58, mirëpo projektin të cilin AK e ka numëruar si të vlefshëm më saktë projektin sipas listës nr.4, vlen të cekët se AK ka kërkuar 2 here radhazi informata sqaruese lidhur me këtë projekt, dhe se në informata e para OE nuk ka mundur të sigurojë, e poashtu e as edhe në informata e 2 pasi që lidhur me këtë projekt ka pranuar vetëm një konfirmimin nga komuna e Prizrenit të datës 21.01.2025 e që përsëri nuk është certifikata e pranimit nga komuna, pasi që OE nuk e ka përfunduar ende certifikimin dhe se nuk dihet sa a do kryhet certifikimi, poashtu çdo dokument shtese i dorëzuar pas datës së ofertimit datës

18.11.2024, ZPP-është dashur ta dije qe është në kundërshtim me LPP dhe Rrpp e poashtu edhe duke shkelur ligjin, pra dosja e tenderit ka Për çdo projekt te realizuar kërkohen Referencat ose Certifikata e Pranimit teknik. Për investitor privat kërkohet Certifikata e pranimit nga komuna, ndërsa AK mund t'i verifikoj edhe transaksionet financiare e jo konfirmimin sipas email dhe se konfirmim i futur 64dite pas hapjes se procesverbalit te datës 18.11.2024,

Pretendimi i trete (3): Lidhur me kërkesën mbi stafin profesional AK ka kërkuar një Inxhinier i dip. i Arkitekturës ose Ndërtimtarisë, me përvojë 10 vjeçare profesionale në menaxhimin e projekteve te punimeve ndërtimore (se paku një objekt shëndetësor), ndërsa OE „Rafi II” ka paraqitur Haxhi Bytyqi ku Menaxheri i kontratës z. Haxhi Bytyci, ka te prezantuar një reference për Renovimin e ambullantes ne Rahovec ne vitin 2009/2010, ndërsa ne kontratën e punës shkruan se z. Haxhi Bytyci ka lidhur kontrate me këtë kompani me date 01.01.2017, e vërtetuara gjithashtu te noteri LRP.NR.8576/2023. Andaj referencia e datës 01.11.2024 dhe kontrata 01.01.2017 nuk përputhen me njëra tjetrën.

Pretendimi i katërt (4) : Sipas kërkesës 3.3 Një Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë - Drejtimi Konstruktiv, se paku 5 vite përvojë profesionale, OE ka paraqitur z. Milot Muhaxheri me para kontratë të datës 12.11.2024, ndërsa duke e shiquar CV e inxhinierit e nënshkruara nga vet inxhinieri tek eksperiencia profesionale nr.13 është deklaruar që punon në këtë kompani nga Prill 2018 dhe vazhdon ende, mirëpo kompania Rafi sh.p.k ka lëshuar një referencë për z. Milot Muhaxheri me date 01.11.2024, dhe të pse janë të gjitha këto të dhëna të inxhinierit, ai nuk figuron në listën e Administratës Tatimore te Kosovës te datës 14.11.2024. Ne referencën e leshura për z. Milot Muhaxheri thuhet se ka qene Projekt Menaxher i disa projekteve, nder tjerash edhe projekti i përfunduar ne vitin 2024 – Amelia Residential and Commercial Building B+P+8, Prizren nga 2021/202, andaj si ishte e mundur të menaxhoje këtë projekt dhe të mos figurohet në 6 mujorin e listës së lëshuar nga ATK. Mos deklarimi i punëtorëve që angazhohen në projekte direkt është vepër e rendë, e që referencia e datës 01.11.2024 nuk dëshmon vërtetësi e angazhimit te z. Milot Muhaxherit në këto projekte. Diploma e dorëzuar në oferte e z. Milot Muhaxheri është në gjuhen Italiane, dhe bie në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik LPP për gjuhët zyrtare.

Me datën 31.01.2025 AK ka lëshuar vendimin mbi refuzimin e kërkesë për rishqyrtim dhe lidhur me këtë pretendim ka theksuar:

Mirëpo edhe pas argumenteve dhe administrimit të provave dhe fakteve, AK përsëri vazhdon me pretendimet e njëjta dhe jep sqarime sa për të theksuar diçka mbi piken e argumentit, mirëpo nuk i merr për bazë fare pikat se si OE lëshon referencia të rrejshme, nuk vërteton se a ka punuar real punëtori ne këtë kompani, dhe se a është i deklaruar ne ATK, duke ditur se mos deklarimi i punëtorëve është në kundërshtim me ligin e Kosovës dhe me ligjin e punës, andaj OE krijon referencia të rrejshme e që këto janë vërtetuar dhe argumentuar tek AK përmes sdi sa fakteve,

Pretendimi i pestë (5): Lidhur me kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale tek kërkesa nr. 4 OE duhet të posedojë mjete stabilimentet dhe pajisjet teknike si dëshmi duhet te ofrohen librezat qarkullimit për mjetet qe regjistrohen ndërsa për mjetet qe nuk regjistrohen te ofroj dëshmi dudin doganore apo faturen me transaksion bankare mbi shitblerjen OE ka ofruar makineri në kundërshtim me DT, edhe pas administrimit te provave dhe fakteve AK me vendimin e datës 31.01.2025 ka theksuar se OE:

Mirëpo pas verifikimit të dosjes së dorëzuar nga ofertuesi me datën 18.11.2024, dhe pas qasjes në dokumentet zyrtar të OE fitues Rafi II, ne kemi hasur në disa makineri të cilat nuk i plotësoj

kriteret konform DT-,dhe se ZPP-AK vazhdon refuzon dhe vazhdon përsëri po me te njëjta argumente dhe favorizime ndaj këtij OE , lidhur me disa makineri do tregojmë argumentet dhe faktet te bashkangjitura në këtë ankesë:

Makinë për nivelizim të estriut- OE Rafi ka prezantuar një marrëveshje bashkëpunimi me kompaninë N.N.Nivelim Loni-Shtime, marrëveshja e datës 10.11.2024, mirëpo vet dhuruesi i kësaj marrëveshjes N.N Nivelim Loni-Shtime nuk e dokumenton që posedon pasijen e tillë sipas kërkesë së DT- pra që kërkohet dudi doganor apo fature me transaksion bankar, ky dhuruesi i marrëveshjes vetëm ka prezantuar një librezë nga shteti zvicerres dhe një foto të kësaj pajisje, tek libreza Zvicrës poashtu nuk shihet se kush e posedon këtë makineri, andaj lidhur me këtë kërkesë OE ka dështuar që konform DT ta plotësoj pra duke e dokumentuar pajisjen sipas dudi doganor me doganë të paguar në Republikën e Kosovës, apo edhe faturën, poashtu vlen të theksohet se nëse kjo pajisje gjendet në Republikën e Kosovës dhe është funksionale mirëpo është e pozicionuar ilegalisht duhet të lajmërohet dogana e Kosovës të konfiskohet, andaj nuk e kemi te qarte se në si pale që kemi aplikuar në këtë tender, si arrin paisje të tilla komisioni vlerësimi dhe AK ti tejkalojnë duke shkelur qartë LPP, duke paraqitur marrëveshje me shkrim dhe vulë e foto, është e mundur nga çdo OE, mirëpo që të jetë konform dosjes së tenderit kërkohet: dudi doganor apo fature me transaksion bankar, gjeni të bashkangjitur në këtë ankesë makineritë e prezantuara nga OE fitues, pa dud, pa fature, pa transaksion bankar.

Makinë për suvatim-OE Rafi ka prezantuar një marrëveshje bashkëpunimi me kompaninë CANI-EARahovec e datës 10.11.2024, mirëpo vet dhuruesi i kësaj marrëveshje CANI-EA[1]Rahovec nuk e dokumenton që e posedon pasijen sipas marrëveshjes, gjë që nuk e plotëson kriterin sipas DT, ku si dëshmi është kërkuar që në rast të pajisjeve që janë pa librezë duhet të dokumentohet përmes dudi doganor apo përmes faturës dhe transaksionit bankar, në këtë rast marrëveshja e mes Rafi dhe CANI-EA ka vetëm foto të makinerisë, dhe se nuk posedon as dud doganor as fature, andaj OE ka dështuar të plotësoj kriterin e DT,

Një (1)Cisternë e ujit : OE Rafi ka prezantuar një marrëveshje bashkëpunimi me kompaninë Benita Company sh.p.k e 12.11.2024, mirëpo tek verifikimi i pasijes dhe nga prodhuesi, paisja del që nuk është cistern adekuate e ujit apo cistern e ujit, paisja e prezantuar nga OE del që është gjysemrimorkio cistern e naftes, dhe duke ditur që në cistern e naftës nuk mundesh të transportojsh uj pasi që janë dy materie të ndryshme, poashtu duke shiquar specifikimin e kërkesës AK ka kërkuar Cistern e ujit, ndërsa OE ka dokumentuar gjysemrimorkio (naftes) pra në 2 koncepte të ndryshme, pra nuk mundet të jetë e njëjtë si cisterna si gjysemrimorkio, dhe sidomos si cistern e ujit në dallim me cistern të naftës, andaj OE ka dështuar të paraqes makinerin konform kërkesave të DT dhe nga vete AK

Neve jemi diskriminuar në këtë tender duke u eliminuar pa të drejtë kurse është favorizu OE i shpërblyer me kontratë pasi që ai nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

Autoriteti kontraktues nuk e ka zbatu edhe nenin 6 të LPP edhe pse janë të obliguar që të garantojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, kur dihet që në këtë aktivitet të prokurimit ne jemi ofertues i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë.

Në këtë tender ne kemi ofertuar me çmim prej 5,328,431.20 €, ndërsa OE i shpërblyer për kontratë me çmim prej 6,299,996.00€.

Diferenca në çmim është 971,565.00 euro andaj nuk duhet të lejohet të dëmtohet buxheti i shtetit për lëshime teknike që nuk ndikojnë fare në përgjegjshmërinë e ofertës. Neni 59.2 i LPP e lejon të kërkohej sqarime mbi cilin do aspekt të tenderit andaj edhe në lidhje me sigurimin e tenderit ka mundur të kërkohej sqarime sepse kemi ët bëjmë me lëshime eventuale.

Është përtej e guximshme të dëmtohet buxheti në vlerë rreth 1 milion euro për kësi gabime teknike..

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë, rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse nuk janë trajtuar të gjithë operatorët ekonomik njëjtë por është favorizuar OE i rekomanduar për kontratë, ndërsa paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Gjithashtu paragrafi 6 i kësaj dispozite, pika (vi) shkruan qartë citojmë “që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse”. Ndërsa në këtë rast OE i rekomanduar për kontratë është i përgjegjshëm dhe oferta e tij nuk përputhet me kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë. Autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “CONEX” L.L.C., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në Neni 1 i LPP-së Neni 6 i LPP-së Neni 7 i LPP-së Neni 13 i LPP-së Neni 56 i LPP-së Neni 59 i LPP-së Neni 68 i LPP-së 4 Neni 60 i LPP-së Neni 69 i LPP-së Neni 72 i LPP-së Neni 97.1 i RRPP Nr.001/2022. Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga ju që të merrni: VENDIM I. APROVOHET, e bazuar ankesa e OE ““Agri Construction”sh.p.k &Conex L.L.C & Pepa Group sh.p.k II. ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) dhe lënda kthehet në RIVLERËSIM dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: Përgjigja e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me kërkesën për rishqyrtim te OE ankues,

Sa i përket pretendimit se OE i rekomanduar nuk i plotëson kriteret e tenderit, është i pa bazuar ky pretendim, meqenëse ne lidhje me kërkesën për realizimin e projekteve te ngjashme nga lamia e punëve në objekte te larta, në vlorë të përgjithshëm jo me pak se 9 Milion Euro, gjatë periudhës se shkuar tre vjeçare nga data e Njoftimit për Kontratë.

OE i rekomanduar i ka prezantuar 6 projekte bazë te realizuara, si dhe aneksi i projekti 1. 3 prej këtyre projekteve te listuar i janë refuzuar Tre projekte:

Për projekti nr. 4 ne liste "Amelia-Faza 3" ne vlere 8,390,052.31 euro (6,805,078.51 + 1,584,973.80), janë kërkuar sqarime shtesë dhe bazuar ne dy sqarimet e ofruara nga OE dhe me dëshmi nga komuna e Prizrenit, ky projekt është i prantieshem për AK, meqenëse dëshmohet se punët janë kiyer, është pranuar nga inspektori i ndërtimit dhe është ne proces per leje te shfrytëzimit.

Ne NJK dhe DT nuk kemi kërkuar qe për objekte private te dëshmohet leje te shfrytëzimit, por kemi kërkuar qe Për investitor privat kërkohet Certifikata e pranimi nga komuna.

Ne bazë te sqarimeve te ofruara, konfirmimit nga Komuna e Prizrenit - Drejtoria e Inspektorateve, është vërtetuar procesverbali i pranimi te projektit nga Inspektorja si procesverbal i inspektimit final.

Ku merren parasysh 3 projektet o pranuar fillimisht ne vlerën e pergjithsme 5,103,667.86 euro: si dhe projekti nr. 4 ne liste "Amelia-Faza 3" ne vlere 8,390,052.31 euro, vlera totale e projekteve te realizuara është rreth 13.5 milion euro, andaj OE i rekomanduar e ka tejkaluar kërkesën e AK.

Sa i përket pretendimeve tuaj ne lidhje me referencën e lëshuar për z. Milot Muhaxheri, listën e lëshuar nga ATK, diplomën e tije, këto janë pretendim te pa bazuara, meqenëse fillimisht lista e kontributeve ne ATK nuk ka qene kërkesë e tenderit dhe nuk kërkohet ne tenderë qe sa vite.

Për inxhinierin Milot Muhaxheri ekziston diploma e noterizuar e Fakulteti te Ndërtimtarisë e Rep. Se Kosovës, si Bachelor i Konstruksionit ndërsa studimet postdiplomike te kryera ne Milano te Italisë diploma e specialistit te inxhinieris Civile dhe doktoratura për-Inxhinieri-Strukturale Sizmike e Gjeoteknike andaj-por AK ky inxhinier është i suporkualifikuar për kërkesat e këtij tenderi.

Sa i përket pretendimit se OE i rekomanduar nuk i ka plotësuar makineritë e kërkuara, ky pretendim është i pa bazuar, meqenëse OE i rekomanduar e ka tejkaluar këtë kërkesë te AK, duke ofruar makineri te shumta ne pronësi si dhe ne marrëveshje dhe kontrata me disa kompani tjera.

Sipas komisionit vlerësues OE i rekomanduar i posedon edhe mjetet qe ju i kontestoni por dëshmitë rreth këtyre pajisjeve ne ofertën e OE te rekomanduar, janë ne gjuhe te huaja ine shume te dhëna dhe shënime dhe është mjaft sfiduese identifikim i saktë i tyre, andaj ne si AK-MSh do ta kemi parasysh qe ne aktivitetet e ardhshme li shmangim maksimalisht kërkesat rreth makinorisë dhe mjeteve te punës dhe to fokusohemi vetëm te kapaciteti ekonomik dhe financiar, stafi inxhinierik dhe referencat për punët e kryera

Sa i përket pretendimit dhe sqarimeve tuaja ne lidhje me konfirmimet e bankave, ky pretendim është i bazuar, meqenëse ne baze to sqarimeve tuaja për konvertimin e mjeteve nga valutat Loke dhe Dollar ne Euro, shihet se e arrijnë vlerën e kërkuar, por komisioni vlerësues nuk o ka pasur to qarte trajtimin e valutave te ndryshme ne këto Konfirmime bankare.

Sa i përket pretendimit luaj për arsyen e dyte te eliminimit tuaj se e komi ofruar sigurimin e lenderit me afat te vlefshmërie prej 120 ditto o nuk e keni ofruar 150 ditë siç është kërkuar, ky pretendim është i pa bazuar, meqense kjo është o rregulluar ne legjislacionin ne fuqi, shih dispozitat e Rregullores se prokurimit ne fuqi nr. 001-2022 (versioni i konsoliduar), citojm se:

28.3 nëse AK imponon kërkesën e sigurimit të tenderit, kërkesa e tillë do të aplikohet për të gjithë tenderuesit dhe kushtet do të parashtrohet në dosjen e tenderit dhe në njoftim për kontratë.

28.6 sigurimi i tenderit do të qëndrojë valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas skadimit të periudhës së validitetit të tenderit.

28.7 sigurimi i tenderit do të qëndrojë valid për një periudhë prej (30) ditë pas skadimit të periudhës së validitetit të tenderit

Ne si AK e kemi në konsideratë nenin 1 të I.PP-së si dhe faktin e dallimit në çmim në mes ofertës tuaj dhe OE të rekomanduar, por krahasuar me vlerën e parashikuar të vendosur në Dosje të tenderit 6,800,619.76 euro e cila rrjedh projekti detaj I hartuar nga projektuesi, OE i rekomanduar është në vlerën 6,299,996.00 euro ose 500,000 euro me lirë se sa vlera e parashikuar në tender.

Oferta juaj prej 5,328,431.20euro është tepër e ulte krahasuar me vlerën e parashikuar, kur dihet se Tenderi nuk ka qenë me kriter të dhënies Çmimi me i Lirë por Ekonomikisht me i favorshëm, si dhe faktit të ditur rreth ngritjes së çmimeve të tregut, fuqisë punëtore dhe sfidave në ekzekutim të projekteve.

Pavarësisht mbështetjes së pretendimit në lidhje me konfirmimet e bankave, kjo nuk e ndryshon konstatonin përfundimtar, meqenëse oferta juaj është administrativisht e papërgjegjshëm bazuar në legjislacionin në fuqi, referuar Udhëzuesit ku specifikohet qartë se:

Sigurimi i Tenderit mungon apo nuk përmban kushtet e përcaktuar sipas formës standarde pjesë e DT Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm 57.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “BM Group” SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Ankesa / Kërkesa për rishqyrtim është e ndarë në 2 Pjesë

Pjesa 1. Plotësimi / Shtjellimi i dokumentacionit për eliminimin tonë OE

Pjesa 2. Shkelja e Ligjit të Prokurimit për Operatorët tjerë Ekonomik.

PJESA 1: Autoriteti Kontraktues: Ministria e Shëndetësisë me publikimin e Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ka bërë shkelje të: Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, ku i njëjti ka paraqitur në këtë njoftim dokumentacione të cilat nuk janë reale, të cilat mund të kërkojnë me nenin 72 të Ligjit të Prokurimit Publik, ku Autoriteti me respektimin e këtij neni: Neni 72. Dokumentacioni dhe informacioni shtesë i cili thekson qartë: 1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përpunime të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

Kërkesë për rishqyrtim e datës 14.10.2024 nga BM GROUP SHPK për: Për Aktivitetin e Prokurimit: 2024/204-24-6755-5-1-1 me titullin: “Ndërtimi i Infrastrukturës në Parkun Industrial

2 - Parku i Përgjithshëm në Drenas” i zhvilluar nga MINT

PRETENDIMI : Lidhur me arsyen e eliminimit

Duke pasur parasysh qe Kriteri Ne FTD për planin dinamik nuk është cekur që do thotë nuk është kusht kryesor për te eliminuar, qka do thotë në asnjë moment AK nuk ka drejtë të na eliminoja për këtë arsye ne si OE te përgjegjshme. Ne si OE te përgjegjshëm kemi plotësuar çdo kushte te cekur ne FTD me përpikëri.

Në këtë rast OE ka vepruar në kundërshtim me nenin 40.12 Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit të rregullores: A002 Versioni i Konsoliduar - Rregullore Nr.002/2024 për Plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Kërkesë për rishqyrtim e datës 14.10.2024 nga BM GROUP SHPK për: Për Aktivitetin e Prokurimit: 2024/204-24-6755-5-1-1 me titullin: “Ndërtimi i Infrastrukturës në Parkun Industrial 2 - Parku i Përgjithshëm në Drenas” i zhvilluar nga MINT

Pra, arsyeja e eliminimit nga ana e juaj është në kundërshtim të plotë me nenin e paraqitur me lartë pasi qe aspekti i planit dinamik nuk është kriter i vlerësimit, i njëjti nuk është as në Njoftimin për Kontratë e as ne pjesën dosjes se tenderit por qe i njëjti është të specifikimet teknike për shërbimet apo punët e ofruara.

Për te qene i kusht i kryesor duhet te jete i paraqitur ne FTD ne pjesën ku janë te vendosura kushtet kryesore , si veprojnë çdo AK kur pikësynim kryesor kanë planin dinamik.

Rast konkret kemi :

Ministria e Rinisë , Kulturës dhe sportit vepron kështu:

Atëherë nëse kishte qene kështu si kusht kryesor automatikisht kishit pase te drejte te nam eliminoni, edhe pse edhe ne këto raste duhet te kërkohet sqarim, sikurse kërkohet sqarim

Kërkesë për rishqyrtim e datës 14.10.2024 nga BM GROUP SHPK për: Për Aktivitetin e Prokurimit: 2024/204-24-6755-5-1-1 me titullin: “Ndërtimi i Infrastrukturës në Parkun Industrial 2 - Parku i Përgjithshëm në Drenas” i zhvilluar nga MINT nëse ne paramase nuk vendose një çmim për një pozicion sipas nenit 39 te rregullores . Ju me këtë veprim vete si AK keni lëshuar një mundësi manipulimi duke pasur parasysh interesat personale te juaja. Me këtë veprim ju vendosni vet se asht kusht kryesor apo dytësorë ne mbarësi prej OE cilin doni ta shpallni . Ne mendojmë se kjo është shkelje e LPP nga ana juaj dhe si kriter kryesor nuk mund te merret për bazë.

Duke pasur parasysh qe plani dinamik është kërkuar ne Aneks 1 ,është ofruar nga ne si OE, vetëm me mungesë të disa pozicioneve AK, ka mundur të kërkoj sqarim ose konfirmim nga se si OE te përgjegjshëm se a mundemi te përfundojmë edhe këto pozicione ne kuadër te planit dinamik te ofruar, sikurse ka kërkuar nga OE i shpallur sqarime. , atëherë AK sipas nenit 59 dhe 72 : Neni 59, paragrafi 2. thekson Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Dhe Neni 72, paragrafi 3. thekson Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për

dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti paragrafi thekson 1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Pra, ju si Autoritet Kontraktues duke mos respektuar nenin 6 pa pyetur, pa u sqaruar, pa kërkuar informacione, mirëpo edhe duke e shkelur nenin 7 të LPP-së i cili thekson në paragrafin 1 Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente, ju e keni shpërblyer një Operator Ekonomik në vlerë financiare mbi 444, 565.96 mijë euro gjë që na bënë të kuptojmë edhe për keqpërdorim të detyrës apo autoritetit zyrtar nga ana e juaj.

PJESA 2: Paraqesim se: Operatori Ekonomik Rafi II Sh.p.k nuk i plotëson këto kritere të paraqitura në Formularin e Dosjes se Tenderit

PRETENDIMI 1. 1. Operatori Ekonomik nuk ka plotësuar kushtin/kriterin :

Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka realizuar me sukses në tërësi projekte të ngjashme nga lomia e punëve në objekte të larta, në vlerë të përgjithshme jo më pak se 9 Milion Euro, gjatë periudhës së shkuar tre vjeçare nga data e Njoftimit për Kontratë. Në rast të konsorciumit, së paku 60% e projekteve kërkohet për liderin e grupit. Së paku njëri nga projektet të jetë nga objekt shëndetësorë - kontratë me vlerë të madhe e realizuar nga lideri i grupit.

Punët të cilat nuk duhen të pranohen janë:

1. Projekti i I-pare : Completion of the Construction of a Neë Sports Centre "Omnisport" and Landscaping Eorks I PROJEKTIM DHE NDERTIM -Annex Reparation of the defective eorks at Omnisport and Minatori in Mitrovica / FIDIC - 3,288,438.44 €- pasi që është përfunduar me shume se 3 vite para datës së njoftimit për Kontratë

2. Projekti i II-te- "AMELIA" Objekti banesor-afariste B+P+7, Prizren / DESIGN AND BUILD/ me 9ertifikat përdorimit 4,471,927.39 € pasi që është përfunduar me shume se 3 vite para datës së njoftimit për Kontratë ose datës së dorëzimit.

3. Projekti i III-te "AMELIA - Faza 3" Ndërtimi i Objektit Afarist me Apartamente

Kërkesë për rishqyrtim e datës 14.10.2024 nga BM GROUP SHPK për: Për Aktivitetin e Prokurimit: 2024/204-24-6755-5-1-1 me titullin: “Ndërtimi i Infrastrukturës në Parkun Industrial 2 - Parku i Përgjithshëm në Drenas” i zhvilluar nga MINT Luksoze, B+P+8, Prizren, PROJEKTIM DHE NDERTIM -8,390,052.31-eshte bere kërkesa për pranim teknik por Kuvendi komunal deri me date 18.11.2024 nuk ka pase asnjë pranim teknik ose certifikatë dhe çdo certifikatë pas kësaj date e lëshuar është e pavlefshme.

Projekti i IV-te- EuropAid/137378/DD/ËKS/XK Construction ofrendering plant category I for animal by products Lot 1 & Lot2 BUILD/CONSTRUCTION - 2,940,401 pasi që është përfunduar me shume se 3 vite para datës së njoftimit për Kontratë 5. Projekti V-te - Upgrade Ofnfastructure Lot 1 1,056,351 .40€ -është përfunduar pjesërisht janë të pranuar nga 9 objekte vetëm 2 qka i bjen se vlera e pranuar mund të jetë përafërsisht $1,056,351 .40€ = 9 \times 117\,372.37$, ku vetëm 2 nga to janë të pranuar që i bie $2 \times 117\,372.37 = 234,744.75$ euro.. Me këtë vetetojmë se ky OE nuk e plotëson kushtin as për se afermi për të qenë i përgjegjshëm. OE –Raf II sh.p.k nuk e

ploteson as për se afermi këtë kusht ku edhe ju vet si

Me këtë vetetojme se ky OE nuk e plotëson kushtin as për se afermi për të qen i përgjegjshëm. OE –Raf II sh.p.k nuk e ploteson as për se afermi këtë kusht ku edhe ju vet si AK e keni vërtetuar se ka vetëm pak mbi rreth 5 milion punë të përfunduara. Dhe pas sqarimeve të ofruara, ju si AK keni marrë për bazë dokument të formuar pas datës së dorzimit të dosjes së tenderit, që kjo nuk lejohet sipas ligjit të prokurimit ku theksohet qartë : Neni 72, paragrafi 3. thekson Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistencë e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive. Me këtë ju AK keni shkelur ligjin e prokurimit duke e shpallur OE si të përgjegjshëm , kurse neve si OE i përgjegjshëm me i lire nuk keni kërkuar asnjë sqarim dhe keni demtuar buxhetin e juaj për rreth 500 mijë euro. Ne mendojmë se ju, si AK keni bërë shkelje të ligjit të disa neneve të cilat janë të cekura më lartë si Neni ,7,10,59,72 etj, me këtë veprim

Pretendimi 2.

1. Mungon në listën e stafit profesional Gjeodeti . Poashtu duke analizuar me poshtë dokumentet vërejtme për disa nga stafit nuk kanë përputhshmëri në mes kontratave të punës si dhe CV të tyre. Si dhe shumica e dokumenteve janë në noterizuar nga kopje, pothuajse asnjë nga Origjinali. I çekim me posht mospershtatjet e CV me kontratat :

1. Kontratat nuk janë në emër të projektit por vetëm kontratë pune ku janë para një r një kohe shumë të gjatë të formuara, pasi që neve si OE të përgjegjshëm na bëjnë të mendojmë që janë shumë fiktive dhe asgjë reale.

a).Bleta Berisha –Arkitekta –Në CV çeket që në RAF II ka punuar vetëm gjatë viteve 2019-2021 e tani punon në një kompani tjetër 3E sh.p.k dhe kontrata është e asaj kohe. Duke pasur parasysh që kjo në CV nuk ka çekur se punon në Raf II-sh.p.k, atëherë është dashur të bëhet kontratë në emër të projektit e jo kontratë e thjeshtë.

b). Jusuf Kurti –Ing i Elektros – është mbi moshën 65 vjeçare, nga OE është ofruar kontratë e vitit 2012 e asnjëherë e ripërtirë . Sipas ligjit të punës,ligjit për marrëdhënie detyrimeve, po ashtu të ligjit prokurimit për këtë person duhet të bëhet një kontratë e veçantë –ose kontratë mbi veprën të çekur me emër të projektit. Kontratat e çekura në pikën a dhe b nuk e plotësojnë kushtin e çekur nga ju si AK.

Pretendimi 3. Nuk është plotësuar kushti i caktuar nga ju si AK:

Kërkesë për rishqyrtim e datës 14.10.2024 nga BM GROUP SHPK për: Për Aktivitetin e Prokurimit: 2024/204-24-6755-5-1-1 me titullin: “Ndërtimi i Infrastrukturës në Parkun Industrial 2 - Parku i Përgjithshëm në Drenas” i zhvilluar nga MINT

Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se posedon me Staf Teknik min. 30 punëtor, me profilin teknik të punës dhe vitet e përvojës.

Dëshmia 2.

- Lista e stafit min. 30 punëtor – origjinale e nënshkruar dhe vulosur;

- Kontratat ose para kontratat mbi marrëdhënien e punës për këtë projekt – kërkohen origjinale (AK për OE pretendues para shpërblimit me kontratë do ti kërkoj ne kopje te fortë).

OE ka ofruar një liste nga ATK si dhe një liste të formuar vete-jo origjinale ku saktësisht nga ajo liste ka vetëm 10 puntor të cilët e plotësojnë këtë kriter. Tjerët janë staff menagjerial si inxhinierë ndertimitare, elektronike, makineri , arkitekt etj si dhe staf administrative si : ekonomist, jurist, mirmbajtës e etj . Qka do thore me këtë ky Operatore as për se afermi nuk e ploteson kushtin të caktuar nga ju prej 30 puntoreve staf teknik.

Pretendimi 4. Nuk është plotësuar kushti i caktuar nga ju si AK: - Lista e mjeteve origjinale, e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik;

OE të shpallur nga ju si OE i përgjegjshëm në listën e mjeteve ka deklaruar që nuk ofron mjete për 2 pajisje në fund për pajisjen : - Një (1) kompresor që tërhiqet mbi 1 ton, Një (1) autokran me kapacitet bartës min. 10 ton, . Si autoritet kontraktues keni punuar me standarde të dyfishta, në njërin anë (edhe pse ishim me të lire na keni eliminuar për diçka që kërkohet me nenin 72, ndërsa e keni shpallur fitues një Operator Ekonomik që thekson dy pajisje nuk i ofron fare (pa asnjë detaj shtese), shtoja kësaj në pajisjet e ofruara të tjera shpesh as nuk shihen të dhënat për verifikim.

Kërkesë për rishqyrtim e datës 14.10.2024 nga BM GROUP SHPK për: Për Aktivitetin e Prokurimit: 2024/204-24-6755-5-1-1 me titullin: “Ndërtimi i Infrastrukturës në Parkun Industrial 2 - Parku i Përgjithshëm në Drenas” i zhvilluar nga MINT

Poashtu OE ka ofruar 2 mikser betoni, të bashkangjitur në faturën 2587/2024 , për duhet të ceket se mikser betoni janë pajisje makineri të mëdha të cilat regjistrohen e jo pajisje dore të cilat blehen me një shumë simbole 30-40 euro. Duke pasur parasysh rëndësinë e projektit mendojmë që AK nuk ka analizuar mirë këtë pjesë të kërkuar nga vete Ata për të vrenjitur se sa mungesa ka OE i propozuar për kontratë.

Për të bërë një paralelizim : Ne si OE kemi ofruar në planë dinamike pozicionet të cilat do përfundohen brenda kohës së caktuar por vetëm nuk kemi cekur ditën dhe kohëzgjatjen e tyre dhe për këtë juve na keni eliminuar pa kërkuar kurrfarë sqarimi dhe duke pasur parasysh që ky kusht nuk ka qenë fare në FTD i cekuar. Kurse e keni marrë të mirëqenë nga OE listën e mjeteve të ofruara në të cilën ceket që 2 pajisje e fundit nuk i ofron fare edhe pse është cekur në FTD. Detaje:

Raf II SHPK ka paraqitur:

1. Marrëveshje bashkëpunimi me: BENITA COMPANY (asnjë dokument nuk është bashkangjitur për makineritë e cekura në këto marrëveshje).
2. Marrëveshje bashkëpunimi me NIVELIM LONI (asnjë dokument nuk është bashkangjitur për makineritë e cekura në këto marrëveshje).
3. Marrëveshje bashkëpunimi me UNIVERSAL (asnjë dokument nuk është bashkangjitur për makineritë e cekura në këto marrëveshje).
4. Marrëveshje bashkëpunimi me CANI-EA (asnjë dokument nuk është bashkangjitur për makineritë e cekura në këto marrëveshje).

Këtu na lenë te kuptojmë që ose AK ka vlerësuar sipas dëshirës se tyre (dhe nuk ka gjetur këto te gjetura tona) ose Operatori Ekonomik me 4/5 marrëveshje te cilat nuk kane dokumentacione nuk ka arritur te plotësojë dokumentacionin dhe dëshiron te marre një pune ne vlere 6.285 milionë euro!.

PRETENDIMI 5: Gjatë qasjes në dokumente zyrtare, Zyra e Prokurimit ka shkelur Ligjin e Prokurimit Publik ku për disa Operator Ekonomik nuk na ka dhënë dokumentacion shembull:

1. Fitorja Sh.p.k

2. Ada Consulsting Group Sh.p.k

Kurse për te tjerët : Pajtohem plotësisht me vendimin e AK Agri Construction, Conex L.L.C dhe Pepa group nuk kane plotësuar kushtet kryesore si sigurimin për ditët e parapara dhe letër mbështetjen dhe sipas rregullores neni 39 , për këtë Operator nuk kërkohet asnjë sqarim dhe eliminohet si OE i përgjegjshëm . për Grupin OE B-Bardhi Sh.p.ksi Lider Pajtohem plotësisht me vendimin e A

Duke i parë shkeljet e paraqitura ne detaje të:

A. Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

B. A01. Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik

C. A02. Udhëzues Nr-001/2023 për prokurimin publik

Duke i parë shkeljet e paraqitura ne detaje të:

D. Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

E. A01. Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik

Kërkesë për rishqyrtim e datës 14.10.2024 nga BM GROUP SHPK për: Për Aktivitetin e Prokurimit: 2024/204-24-6755-5-1-1 me titullin: “Ndërtimi i Infrastrukturës në Parkun Industrial 2 - Parku i Përgjithshëm në Drenas” i zhvilluar nga MINT

F. A02. Udhëzues Nr-001/2023 për prokurimin publik

Arsyetimi i Autoritetit Kontraktues

Pjesa 1 - Pretendimi i pare ne lidhje me arsyen e eliminimit tuaj për mosplotësim te Planit Dinamik, është i pa bazuar ky pretendim dhe është e pa bazuar përpjekja qe te fajësohet AK pse nuk ka kërkuar sqarime shtese konform nenit 72 te LPP-se për ketë gjë. Oferta juaj është e papërgjegjshëm Meqenëse ju nuk e keni plotësuar si duhet Planin Dinamik, si pjese e Dosjes se tenderit, te cilin si shabllon e kemi ngarkuar ne e-prokurim dhe ka qene e domosdoshme për plotësim nga te gjithë ofertuesit.

Pjesa e II- Arsyetimi për pjesën e dyte është complete ne kundërshtime me pjesën e pare pasiqe për pjesën e dyte ka kërkuar sqarime dhe ka pranuar dokumentacione te cilat janë formuluar pas

datës se dorëzimit të dosjes se tenderit . Poashtu autoriteti nuk ka marrë parasysh të gjitha pretendimet tona sidomos për stafin dhe për makineritë që janë kushte kryesore të paraqitura në FTD .

Ne mendojmë dhe besojmë në mbështetje të neneve të LPP se AK ka bërë shkelje të ligjit dhe ka punuar me dy pale standarde . Tjera standarde ka përdorur për ne dhe tjera për OE tjetër. Shihet qarte në planin dinamik tonin të dërguar se ai është gabim teknik e fare nuk është sikurse pretendon AK-kinse skemi dashur të tregojmë se kur do i punojmë këto pozicione. Se me qen ashtu nuk kishim vendosur as çmime në paramase dhe nuk ishim zotuar fare që i përfundojmë ato punë. Kjo shihet qarte për të gjithë ata që punojnë në exel e dijnë se është gabim që bëhet gjatë ruajtjes së të dhënave . Poashtu duke pasur parasysh që plani dinamik nuk është cekur fare në FTD, AK nuk ka pasur të drejtë të na anuloi neve pa se paku një sqarim shtese.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “BM Group” SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar Legjislacioni primar: A. Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 Specifikisht të neneve: Neni 6. Ekonomiciteti dhe Efikasiteti Neni 7. Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi Neni 10. Mjetet për promovimin e Transparencës Neni 11. Informatat Sekrete Afariste Neni 24. Zyrtarët e Prokurimit gjatë Ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit Neni 59. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve Neni 72. Dokumentacioni dhe informacioni shtesë Legjislacionit sekondar: B. A01. Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik Specifikisht të neneve: Neni 7. Informata Sekrete afariste dhe Qasja në Dokumentacion Neni 40. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve C. A02. Udhëzues Nr-001/2023 për prokurimin publik Specifikisht të neneve: Dispozitat e përgjithshme 1. Qëllimi dhe Fushëveprimi i Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve. Besojmë se i kemi elaboruar me shumë se sa që duhet shkeljet e AK-se në këtë aktivitet të Prokurimit andaj, Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr: Ankese të paraqitur nga BM GROUP SHPK / t’a vlerësoi si të BAZUAR. Të ANULOI – Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues – Formularin B58 të datës 22.01.2025. III. Aktivitetin e prokurimit: Ndërtimi i objektit të ri për Institutin Special në Shtime” me numer: 206-24-187-5-1-1 ta kthejë në RIVLERËSIM dhe të DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së. Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetent

Përgjigje e AK në kërkesën për rishqyrtim: Përgjigja e Autoritetit Kontraktues në lidhje me kërkesën për rishqyrtim të OE ankues:

Pjesa 1 - Pretendimi i parë në lidhje me arsyen e eliminimit tuaj për mosplotësim të Planit Dinamik, është i pa bazuar ky pretendim dhe është e pa bazuar përpjekja që të fajësohet AK pse nuk ka kërkuar sqarime shtese konform nenit 72 të LPP-se për këtë gjë.

Oferta juaj është e papërgjegjshme meqenëse ju nuk e keni plotësuar si duhet Planin Dinamik, si pjesë e Dosjes së tenderit, të cilin si shabllon e kemi ngarkuar në e-prokurim dhe ka qenë e dornosdoshme për plotësim nga të gjithë ofertuesit.

Kërkesa për Planin Dinamik ka qenë e specifikuar qarte në Aneksin 1 të DT dhe ne ju kemi dhënë instruksionet e sakta se si duhet të plotësohet, duke i selektuar me ngjyre të verdhe sqarimet tona, si në vijim:

ANEKS 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Shenim: AK ka vendosur afatin kohor, konform normave dhe standardeve ndërtimore, si dhe ndarjeve buxhetore, ku është vlerësuar afatit për implementim të këtij projekti max. 24 muaj. OE duhet të dorëzon me Ofertën e tij, “” duke plotësuar Formën Standarde të Planit Dinamik të publikuar si dokument shtese në e-prokurim tek Dosja e Tenderit.

Për secilin pozicion të përshkruar në paramasë duhet të shënohet numri i ditëve të nevojshme për përfundimin e pozicionit të caktuar. Plani dinamik duhet të jetë konform normave dhe standardeve- Nuk e keni plotësuar në teresi kolonën C - AFATI I PARAPARE PËR FILLIMIN E PUNEVE - në të cilën shënohet dita se kur do të fillojë ekzekutimi i një pozicioni të caktuar, si dhe Nuk e keni plotësuar në teresi kolonën Kolona D - AFATI I PARAPARE PËR KRYERJEN E PUNEVE – në të cilën shënohet numri i ditëve sa do të zgjasë ekzekutimi i një pozicioni të caktuar. Nuk e keni plotësuar kolonën C dhe D për kapitullin nr. 5. - MAKINERI DHE PAJISJE - MBROJTA NGA ZJARRI MNZ, e cili kapitull në vetvete përfshinë 28 pozicione me sasi të punëve sipas paramasës. Për këto pozicione nuk dihet fillimi dhe për sa do të kryhen. Mungesa e kësaj pjese e bënë tere Planin Dinamik të pa vlefshëm meqenëse edhe totali i ditëve nuk është real përderisa nuk është i plote.

Është e drejtë e AK të kërkojë plotësimin e Planin Dinamik të Detajuar nga të gjithë OE, ju jeni pajtuar me këtë kërkesë të DT dhe nuk e keni kundërshtuar gjatë fazës së tenderimit, andaj është detyrë ta plotësoni siç e kanë plotësuar të gjitha OE tjerë.

Sipas nenit 59.4 dhe 72 të LPP-se lejohen sqarimet shtese, por edhe ato sqarime kanë rregulla dhe kufizime. Nuk mund të kërkojë nga OE gjatë procesit të vlerësimit që të plotësohen ditët e pa plotësuara në Planin dinamik, se ajo është ndryshim i ofertës. Me sqarime shtese mund të sqarohen mangësitë ose paqartësitë në informacion apo dokumentacion, ndërsa në këtë rast në nuk kemi asnjë paqartësi, meqenëse komisioni vlerësues e ka evidentuar mjaft shpejt se 28 pozicione me sasi të punëve sipas paramasës nuk janë plotësuar nga ana juaj.

Ju duhet ta kuptoni drejtë nenin 72.1 dhe 72.3 të LPP-se:

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

3. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistencë të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Pjesa 2: Pretendimi i parë se OE i rekomanduar nuk i plotëson kriteret e tenderit, është i pa bazuar ky pretendim, meqenëse në lidhje me kërkesën për realizimin e projekteve të ngjashme nga lomia e punëve në objekte të larta, në vlerë të përgjithshme jo më pak se 9 Milion Euro, gjatë periudhës së shkuar tre vjeçare nga data e Njoftimit për Kontratë.

OE i rekomanduar i ka prezantuar 6 projekte bazë të realizuara, si dhe aneksi i projektit 1. 3 prej këtyre projekteve të listuara i janë refuzuar tre projekte:

projekti nr. 1 kontrata baze (3,288,438.44 euro) përfundimin e ka ne 2019,

projekti nr. 2 (4,471,927.39 euro) përfundimin e ka prill 2021,

projekti nr. 5 (2,940,401.45 euro) përfundimin e ka mars 2021,

për projektin nr. 4 ne liste "Amelia-Faza 3" ne vlere 8,390,052.31 euro (6,805,078.51 + 1,584,973.80), janë kërkuar sqarime shitesë dhe bazuar ne dy sqarimet e ofruara nga OE dhe me dëshmi nga komuna e Prizrenit, ky projekt është i pranueshëm për AK, meqenëse dëshmohet se punët janë kryer, është pranuar nga inspektori i ndërtimit dhe është ne proces për leje te shfrytëzimit.

Ne NJK dhe DT nuk kemi kërkuar qe për objekte private te dëshmohet leje te shfrytëzimit, por kemi kërkuar qe Për investitor privat kërkohet Certifikata e pranimi nga komuna. Ne baze te sqarimeve te ofruara, konfirmimit nga Komuna e Prizrenit - Drejtoria e Inspektorateve, është

Ku merren parasysh 3 projektet e pranuar fillimisht ne vlerën e përgjithshme 5,103,667.86 euro: aneksi i projektit nr. 1 ne vlere 522,981.13 euro, projekti nr. 3 ne vlere 3,524,335.33 euro, projekti nr. 6 ne vlere 1,056,351.40 euro. si dhe projekti nr. 4 ne liste "Amelia-Faza 3" ne vlere 8,390,052.31 euro, vlere totale e projekteve te realizuara është rreth 13.5 milion euro, andaj OE i rekomanduar e ka tejkaluar kërkesën e AK.

Pretendimi i dytë se OE i rekomanduar nuk e ka plotësuar stafin profesional dhe se mungon ne liste gjeodeti, ky pretendim është i pa bazuar, meqenëse kjo është devijim i vogël dhe nuk ka ndonjë relevance për AK, duke marre parasysh se OE i rekomanduar e ka ofruar gjeodetin z. Bardhyl Kryeziu me Para Kontrate për këtë projekt, diplome te noterizuar, CV, Licence valide te noterizuar.

Pretendimi i tretë se OE i rekomanduar nuk e ka plotësuar stafin prej 30 punëtoreve siç është kërkuar, ky pretendim është i pa bazuar, meqenëse OE i rekomanduar përveç listës se vet, e ka ofruar edhe Listën e ATK-se te vitit 2024 me kontribute për 36 punëtor, andaj për informimin tuaj Lista e ATK-se është shume me bindëse për AK se sa çfarë do liste tjetër qe e hartojnë OE.

OE i rekomanduar i ka tejkaluar kërkesat e AK, duke dëshmuar kualifikime shume me te larta për stafin e punëtoreve, andaj kjo nuk mund ti kontestohet OE por është ne te mire te AK dhe projektit.

Pretendimi i katërt se OE i rekomanduar nuk i ka plotësuar makineritë e kërkuara, ky pretendim është i pa bazuar, meqenëse OE i rekomanduar e ka tejkaluar këtë kërkesë te AK, duke ofruar makineri te shumta ne pronësi si dhe ne marrëveshje dhe kontrata me disa kompani tjera.

OE i rekomanduar i posedon edhe mjetet qe ju i kontestoni Një (1) kompresor që tërhiqet mbi 1 ton, Një (1) autokran me kapacitet bartës min. 10 ton, por dëshmitë rreth këtyre pajisjeve ne ofertën e OE te rekomanduar, janë ne gjuhe te huaja me shume te dhëna dhe shënime dhe është mjaft sfiduese identifikimi i saktë i tyre, andaj ne si AK-MSh do ta kemi parasysh qe ne aktivitetet e ardhshme ti shmangim maksimalisht kërkesat rreth makinerisë dhe mjeteve te punës dhe te fokusohemi vetëm te kapaciteti ekonomik dhe financiar, stafi inxhinierik dhe referencat për punët e kryera.

Pretendimi 10, se nuk u kemi dhënë qasje te plote, kjo është e pa vërtet, përfaqësuesi juaj e ka nënshkruar letrën për pranimin e dokumentacionit të kërkuar, ndërsa për dy ofertat e cekura nga ju, nuk ua kemi refuzuar qasjen por ka qene pajtueshmëria e përfaqësuesit tuaj qe mos ti rnarre, meqenëse nuk e atakojnë ofertën tuaj se janë me te shtrenjta.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 14.02.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0105/2025, ndërsa me datë 27.02.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 0105/2025 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues te aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 13.02.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0106/2025, ndërsa me datë 21.02.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 0106/2025 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës 2025/0105 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Raportin e ekspertizës 2025/0106 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk ka dhen përgjigje rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertes, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “CONEX” L.L.C., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0105 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues, sqaron se operatori ekonomik ankues (Conex L.L.C), i pakënaqur me vendimin e Autoritetit Kontraktues / Ministria e Shëndetësisë, ka parashtruar ankese ne OSHP, me pretendimin se autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar kryesisht dispozitat ligjor të nenit 59 të Ligjit për Prokurim Publik (LPP).

Eksperti shqyrtues sqaron se, Autoriteti kontraktues pas përfundimit të vlerësimit të ofertave me datë 22.01.2025 e njofton operatorin ekonomik ankues me letrën standarde të tenderuesit të eliminuar, në të cilën i ka dhënë arsyet e eliminimit ndërsa ka rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik: Raf II SHPK – Rahovec.

Lidhur me arsyet e eliminimit, Eksperti shqyrtues, sqaron se operatori ankues me datën 27.01.2025 ka parashtruar kërkesën për Ri-shqyrtim, ndërsa me datën 31.01.2025 autoriteti kontraktues ka Refuzuar si të pabzua kërkesën për ri-shqyrtim të operatorit ankues, lidhur me aktivitetin e prokurimit me Titull: : Ndërtimi i objektit të ri për Institutin Special në Shtime

OE ankues eliminohet me arsyetimin se:

Sa i përket arsyetimit të parë të eliminimit, eksperti shqyrtues sqaron se Autoriteti Kontraktues në dosje të tenderit ka kërkuar:

Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme AK se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit (2021-2022-2023) ka qenë në vlerë se bashku në të tri vitet jo më pak se 12 milion Euro (në rast të grupit min. 60% të plotësohet nga lideri).

Dëshmia 1. Deklaratat e dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës apo në vendin e themelimit të kompanisë, APO Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menaxhimit të certifikuar nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur.

OE ankues në ofertën e tij financiare ka dorëzua këtë gjendje të llogarisë së liderit të konzorciumit:

Lidhur me këtë çështje, eksperti shqyrtues sqaron se AK, në vendimin e kërkesës për rishqyrtim e ka aprovuar këtë pretendim të OE ankues, me arsyetimin si më poshtë:

Eksperti shqyrtues, lidhur me këtë arsyetimin të AK-së sqaron se gjatë vlerësimit të ofertave është dashur ta bëjë konvertimin e valutave të huaja dhe poashtu konform dëshmisë nr. 1 të kërkuar në dosje të tenderit të konvertojë të gjitha vlerat sepse edhe dëshmitë e lëshuara (nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve – Shqipëri) janë në Lek.

Lidhur me arsyen tjetër të eliminimit, ku OE ankues nuk e ka ofruar sigurimin e ofertës konform kërkesës së dosjes së tenderit, ku Autoriteti Kontraktues ka kërkuar një afat prej: 150 ditësh, ndërsa OE ankues e ka ofruar vetëm për 120 dite.

Lidhur me këtë çështje OE ankues në ankesën e tij pretendon se “kompania në fjalë ka bërë një lëshim teknik kur e ka bërë sigurimin duke e bërë për 120 ditë, ndërsa në nuk e kemi vërejt këtë lëshim duke besuar në profesionalizmin e tyre” dhe njëherit lidhur me këtë çështje i ka bashkangjitur edhe komunikimet elektronike që ka pasur me kompaninë e sigurimeve Sigkos, të cilët janë deklaruar se gabimi teknik ka ndodhur nga ana e kompanisë dhe njëherit janë të gatshëm ta mbulojnë vlefshmërinë prej 150 ditësh.

Eksperti shqyrtues, sqaron se sipas dispozitave të legjislationit sekondar, kërkesa për sigurim të ofertës në rast se nuk plotësohet siç kërkohet apo nuk i përmban kushtet e përcaktuara sipas dosjes së tenderit, refuzohet pa kërkuar sqarim të mëtejshme. Prandaj, eksperti shqyrtues vlerëson se AK, me të drejtë e ka eliminuar.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues ka pretendime ankimore lidhur me ofertën e te rekomanduarit për kontrate, konkretisht pretendon se i rekomanduari për kontrate, nuk e plotëson kërkesën për kontrata dhe referenca. Eksperti shqyrtues, sqaron se ky pretendim i OE ankues qëndron dhe njeherit sqaroj se përgjigjen lidhur me këtë pretendim e kam dhënë ne raportin e ekspertizës me nr: 106/2025.

Poashtu OE ankues pretendon se i rekomanduari për kontrate nuk i ka ofruar dëshmitë konform kërkesave te dosjes se tenderit, lidhur me pajisjet e kërkuara për realizimin e projektit.

Nisur nga fakti qe vet autoriteti kontraktues e pranon se dëshmitë e ofruara për pajisje nuk janë sipas kërkesave te dosjes se tenderit, eksperti shqyrtues sqaron se qëndron ky pretendim dhe këtë përgjigje e kam ne raportin e ekspertizës me nr. 106/2025 dhe i rekomandoj autoritetit kontraktues qe gjate vlerësimit te ofertave te respektohet Neni 59 dhe 13 i LPP-se.

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontrate, lidhur me kërkesën mbi stafin profesional AK ka kërkuar një Inxhinier i dip. i Arkitekturës ose Ndërtimtarisë, me përvojë 10 vjeçare profesionale në menaxhimin e projekteve te punimeve ndërtimore (se paku një objekt shëndetësor), ndërsa OE „Rafi II” ka paraqitur Haxhi Bytyqi ku Menaxheri i kontratës z. Haxhi Bytyci, ka te prezantuar një reference për Renovimin e ambullantes ne Rahovec ne vitin 2009/2010, ndërsa ne kontratën e punës shkruan se z. Haxhi Bytyci ka lidhur kontrate me kete kompani me date 01.01.2017, e vërtetuar gjithashtu te noteri LRP.NR.8576/2023. Andaj referenca e datës 01.11.2024 dhe kontrata 01.01.2017 nuk përputhen me njëra tjetrën, sipas OE ankues.

Lidhur me këtë pretendim, eksperti shqyrtues, sqaron se qëndroni pretendimi i OE ankues dhe ne rastin konkret autoriteti kontraktues eshet dashur te sqarohet duke u bazuar ne nenin 72 te LPP-se.

OE ankues pretendon se sipas kërkesës 3.3 Një Inxhinier i Diplomuar i Ndërtimtarisë - Drejtimi Konstruktiv, se paku 5 vite përvojë profesionale, OE ka paraqitur z. Milot Muhaxheri me para kontratë të datës 12.11.2024, ndërsa duke e shiquar CV e inxhinierit e nënshkruara nga vet inxhinieri tek eksperiencia profesionale nr.13 është deklaruar që punon në këtë kompani nga Prill 2018 dhe vazhdon ende, mirëpo kompania Rafi sh.p.k ka lëshuar një referencë për z. Milot Muhaxheri me date 01.11.2024, dhe të pse janë të gjitha këto të dhëna të inxhinierit, ai nuk figuron në listën e Administratës Tatimore te Kosoves te datës 14.11.2024. Ne referencën e lëshuar per z. Milot Muhaxheri thuhet se ka qene Projekt Menaxher i disa projekteve, nder tjerash edhe projekti i përfunduar ne vitin 2024 – Amelia Residential and Commercial Building B+P+8, Prizren nga 2021/202, andaj si ishte e mundur të menaxhoje këtë projekt dhe të mos figurohet në 6 mujorin e listës së lëshuar nga ATK. Mos deklarimi i punëtorëve që angazhohen në projekte direkt është vepër e rendë, e që referenca e datës 01.11.2024 nuk dëshmon vërtetësi e angazhimit te z. Milot Muhaxherit në këto projekte. Diploma e dorëzuar në oferte e z. Milot Muhaxheri është në gjuhen Italiane, dhe bie në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik LPP për gjuhet zyrtare.

Pretendimi i OE ankues lidhur me diplomën e inxhnierit te Ndërtimtarisë - Drejtimi Konstruktiv, ku pretendon se e ka ofruar ne gjuhen italiane qëndron dhe te njëjtën autoriteti kontraktues e ka pranuar ne vendimin e kërkesës për rishqyrtim.

Lidhur me pretendimet e OE “BM Group” SH.P.K.,- eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0106 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues, sqaron se operatori ekonomik ankues (BM Group SH.P.K), i pakënaqur me vendimin e Autoritetit Kontraktues / Ministria e Shëndetësisë, ka parashtruar ankese ne OSHP, me pretendimin se autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar kryesisht dispozitat ligjor të nenit 59 të Ligjit për Prokurim Publik (LPP).

Eksperti shqyrtues sqaron se, Autoriteti kontraktues pas përfundimit të vlerësimit të ofertave me datë 22.01.2025 e njofton operatorin ekonomik ankues me letrën standarde të tenderuesit të eliminuar, ne të cilën i ka dhënë arsyet e eliminimit ndërsa ka rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik: Raf II SHPK – Rahovec.

Lidhur me arsyet eliminimit, Eksperti shqyrtues, sqaron se operatori ankues me datën 27.01.2025 ka parashtruar kërkesën për Ri-shqyrtim, ndërsa me datën 30.01.2025 autoriteti kontraktues ka Refuzuar si të pabzua kërkesën për ri-shqyrtim të operatorit ankues, lidhur me aktivitetin e prokurimit me Titull: : Ndërtimi i objektit të ri për Institutin Special në Shtime

OE ankues eliminohet me arsyetimin se:

Lidhur me arsyen e eliminimit, ku autoriteti kontraktues ka konstatuar se oferta e OE ankues është e papërgjegjshme për arsye se nuk e ka plotësuar si duhet Planin dinamik si pjesë e dosjes së tenderit, eksperti shqyrtues, pas analizimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit, ofertës së OE ankues, sqaron se AK-MSH në dosje të tenderit ka kërkuar që:

OE duhet të dorëzon me Ofertën e tij, “Planin Dinamik të Detajuar” duke plotësuar Formën Standarde të Planit Dinamik të publikuar si dokument shtesë në eprokurim tek Dosja e Tenderit.

Për secilin pozicion të përshkruar në paramasë duhet të shënohet numri i ditëve të nevojshme për përfundimin e pozicionit të caktuar. Plani dinamik duhet të jetë konform normave dhe standardeve ndërtimore.

Operatori Ekonomik pas nënshkrimit të kontratës në kordinim me menaxherin e kontratës të Autoritetit Kontraktues, do të bëjë adaptimin e planit dinamik të dorëzuar sipas datës së planifikuar për fillimin e ekzekutimit të punëve.

Eksperti shqyrtues, sqaron se, OE ankues, pretendon se Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 59.2 të LPP-se, në të cilin thuhet: Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, eksperti shqyrtues, vlerëson se qëndron ky pretendim i OE ankues, sepse duke marrë parasysh edhe çmimin me të lirë, autoriteti kontraktues është dashur të kërkojë sqarim shtesë, për faktin se plani dinamik si dëshmi përdoret në një fazë tjetër, pra pas nënshkrimit të kontratës dhe poashtu qëndron pretendimi i OE ankues se autoriteti kontraktues e ka diskriminuar sepse ka kërkuar sqarime nga i rekomanduari për kontratë i cili është me çmim me të shtrenjta ndërsa nga OE ankues nuk ka kërkuar sqarim për planin dinamik.

Lidhur me këtë çështje AK-MSH, në përgjigje të kërkesës për rishqyrtim ka deklaruar se kërkesa për informacione shtesë përben ndryshim të ofertës, ndërsa në specifikacion teknik, e ka lënë

mundësin e ndryshimit të planit dinamik, pas nënshkrimit të kontratës, siç është cituar më lartë. Prandaj ekspertja sqaron se, nuk qëndron arsyetimi i AK-se dhe njëje rit vlerësoj se AK konform dispozitave ligjore të nenit 59.2 të LPP-se të kërkojë sqarime shtese lidhur me planin dinamik kjo për faktin se vet autoriteti kontraktues e ka parapare ndryshimin apo plotësimin e planit dinamik.

Pretendimi nr. 1

OE ankues pretendon se Operatori Ekonomik i rekomanduar nuk ka plotësuar kushtin/kriterin : Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka realizuar me sukses në tërësi projekte të ngjashme nga lomia e punëve në objekte të larta, në vlerë të përgjithshme jo më pak se 9 Milion Euro, gjatë periudhës së shkuar tre vjeçare nga data e Njoftimit për Kontratë. Në rast të konsorciumit, së paku 60% e projekteve kërkohet për liderin e grupit. Së paku njëri nga projektet të jetë nga objekt shëndetësorë - kontratë me vlerë të madhe e realizuar nga lideri i grupit njëherit OE ankues pretendon se OE –Raf II sh.p.k nuk e plotëson as për se afërmi këtë kusht ku edhe ju vet si AK e keni vrenjtur se ka vetëm pak mbi rreth 5 milion punë të përfunduara. Dhe pas sqarimeve të ofruara, ju si AK keni marrë për bazë dokument të formuar pas datës së dorëzimit të dosjes së tenderit, që kjo nuk lejohet sipas ligjit të prokurimit ku theksohet qartë: Neni 72, paragrafi 3

Ekspertja shqyrtues sqaro se autoriteti kontraktues të kërkesës nr. 1 Kapaciteti teknik dhe profesional të dosjes së tenderit ka kërkuar:

Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka realizuar me sukses në tërësi projekte të ngjashme nga lomia e punëve në objekte të larta, në vlerë të përgjithshme jo më pak se 9 Milion Euro, gjatë periudhës së shkuar tre vjeçare nga data e Njoftimit për Kontratë. Në rast të konsorciumit, së paku 60% e projekteve kërkohet për liderin e grupit. Së paku njëri nga projektet të jetë nga objekt shëndetësorë - kontratë me vlerë të madhe e realizuar nga lideri i grupit.

Dëshmia 1.

Një Listë (tabelë) të projekteve të realizuara, kërkohet origjinal e vulosur dhe e nënshkruar, me këto të dhëna - Titulli i kontratës,

- Investitori,
- Të dhënat e personit kontaktues,
- Datën e fillimit dhe të përfundimit të projektit,
- Vlerën e projektit.

Për çdo projekt të realizuar kërkohen Referencat ose Certifikata e Pranimit teknik.

Për investitor privat kërkohet Certifikata e pranimit nga komuna, ndërsa AK mund t'i verifikoj edhe transaksionet financiare.

Eksperti shqyrtues, sqaron se Autoriteti Kontraktues, nuk i ka pranuar kontratat me numer rendor: 1, 2 dhe 5 dhe këtë fakt e ka sqaruar edhe në vendimin e kërkesës për rishqyrtim ku sipas AK-se vlera arrin në 13.5 milion euro.

Ekspertja shqyrtues pas analizimit dhe shqyrtimit të dëshmive të ofruara për kontratat me nr rendor: 3, 4 dhe 6, fillimisht sqaron se OE ankues i konteston të gjitha kontratat, mirëpo eksperti

shqyrtues sqaron se kontrata me nr: rendor 4 – Amelia – faza 3 e kalon vleren prej: 8,000,000.00€.

Ekspertja shqyrtues, pasi ka analizuar dëshmitë pre kitë kontrate sqaron se nuk ka certifikate te pranimit, por ka vetëm një kërkesë për pranim teknik te datës: 16.10.2024, fakt te cilin e pranon edhe autoriteti kontraktues ne vendimin e kërkesës për rishqyrtim, e cila përveç qe e pranon deklaron se për neve si AK, është pranueshme sepse kemi kërkuar sqarime dhe ky projekt është pranuar nga inspektorati i ndërtimit dhe pranohet nga AK.

Eksperti shqyrtues sqaron se Autoriteti kontraktues ka kërkuar qe: Për investitor privat kërkohet Certifikata e pranimit nga komuna, ndërsa AK mund t'i verifikoj edhe transaksionet financiare, certifikate te cilën nuk e ka orfuar OE i rekomanduar për kontrate, prandaj ky pretendim i OE ankues qëndron.

Pretendimi nr. 2.

OE ankues pretendon se mungon ne listën e stafit profesional Gjeodeti po ashtu OE ankues pretendo qe pas analizimit të dokumenteve kam vërejtur qe disa nga stafi i OE te rekomanduar për kontrate nuk kanë përputhshmëri ne mes kontratave te punës si dhe CV te tyre si dhe shumica e dokumenteve janë ne motorizuara nga kopje, pothuajse asnjë nga Origjinali. Mospërshtatjet e CV me kontratat :

1. Kontratat nuk janë ne emër te projektit por vetëm kontrate pune ku janë para një kohe shume te gjate te formuara, pasi qe neve si OE te përgjegjshëm na bëjnë te mendojmë qe janë shume fiktive dhe asgjë reale.

a) Bleta Berisha –Arkitekthe –Ne CV ceket qe ne RAF II ka punuar vetëm gjate viteve 2019-2021 e tani punon ne një kompani tjetër 3E sh.p.k dhe kontrata është e asaj kohe. Duke pasur parasysh qe kjo ne CV nuk ka cekur se punon ne Raf II-sh.p.k, atëherë është dashur te behet kontrate ne emër te projektit e jo kontrate e thjeshte.

b) Jusuf Kurti –Ing i Elektros – është mbi moshën 65 vjeçare, nga OE është ofruar kontrate e vitit 2012 e asnjëherë e ripërtërirë . Sipas ligjit te punës, ligjit për marrëdhënie detyrimeve, po ashtu te ligjit prokurimit për ketë person duhet te behet një kontrate e veçantë –ose kontrate mbi vepër te cekur me emër te projektit. Kontratat e cekura ne piken a dhe b nuk e plotësojnë kushtin e cekur nga ju si AK.

Eksperti shqyrtues pas shqyrtimi te dokumentacionit, ofertës se OE te rekomanduar për kontrate sqaron se pretendimet e OE ankues, te cituara me larte, nuk mund te konsiderohen si pretendime te bazuara edhe pse janë evidentuar siç pretendon OE ankues, mirëpo te njëjtat mund te sqarohen konform dispozitave te nenit 72 te LPP-se.

Pretendimi nr 3.

OE i rekomanduar për kontrate është plotësuar kushti i caktuar nga ju si AK: OE i rekomanduar ka ofruar një liste nga ATK si dhe një liste te formuar vete-jo origjinale ku saktësisht nga ajo liste ka vetëm 10 punëtor te cilët e plotësojnë ketë kriter. Te tjerët janë staf menaxherial si inxhinierë ndërtimtarë, elektronike, makineri , arkitekt si dhe staf administrative si : ekonomist, jurist, mirëmbajtës e etj . çka do te thotë se ky Operatore as për se afërmi nuk e plotëson kushtin te caktuar nga ju prej 30 punëtorë staf teknik.

Eksperti shqyrtues, sqaron se AK te kërkesa nr. 2 e dosjes se tenderit ka kërkuar:

Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se posedon me Staf Teknik min. 30 punëtor, me profilin teknik te punës dhe vitet e përvojës.

Dëshmia 2.

- Lista e stafit min. 30 punëtor – origjinale e nënshkruar dhe vulosur;
- Kontratat ose para kontratat mbi marrëdhënien e punës për këtë projekt – kërkohen origjinale (AK për OE pretendues para shpërblimit me kontratë do ti kërkoj ne kopje te fortë).

Eksperti shqyrtues, duke u bazuar ne kërkesën e dosjes se tenderit te cituar me larte, sqaron se nuk qëndron ky pretendim për faktin se nuk është kërkuar qe te dëshmohet me liste te ATK-se numri i punëtoreve.

Pretendimi nr. 4

OE ankues pretendon se nuk është plotësuar kushti i caktuar nga AK: sa i përket listës se mjeteve origjinale, e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik;

OE i rekomanduar për kontrate ne listën e mjeteve ka deklaruar qe nuk ofron mjete për 2 pajisje ne fund për pajisjen : - Një (1) kompresor që tërhiqet mbi 1 ton, Një (1) autokran me kapacitet bartës min. 10 ton, .

OE ankues pretendon se i rekomanduari për kontrate dy pajisje nuk i ofron fare (pa asnjë detaj shtese), shtoja kësaj ne pajisjet e ofruara te tjera shpesh as nuk shihen te dhënat për verifikim Po ashtu OE ka ofruar 2 mikser betoni, te bashkangjitur ne faturën 2587/2024 , por duhet te ceket se mikser betoni janë pajisje makineri te mëdha te cilat regjistrohen e jo pajisje dore te cilat blihen me një shumë simbole 30-40 euro. OE ankues pretendon se i rekomanduari me 4/5 marrëveshje nuk e plotëson kërkesën e AK.

1.Marrëveshje bashkëpunimit me: BENITA COMPANY (asnjë dokument nuk është bashkangjitur për makineritë e cekura në këto marrëveshje).

2.Marrëveshje bashkëpunimi me NIVELIM LONI (asnjë dokument nuk është bashkangjitur për makineritë e cekura në këto marrëveshje).

3.Marrëveshje bashkëpunimit me UNIVERSAL (asnjë dokument nuk është bashkangjitur për makineritë e cekura në këto marrëveshje).

4.Marrëveshje bashkëpunimit me CANI-EA (asnjë dokument nuk është bashkangjitur për makineritë e cekura në këto marrëveshje).

Eksperti shqyrtues, sa i përket pretendimit te OE ankues, lidhur me dëshmitë për pajisjet te cilat i konteston, Eksperti shqyrtues, sqaron se Autoriteti Kontraktues ne ketë rast ka vepruar ne kundërshtim me dispozitat ligjore të nenin 59 te LPP-se, për arsye se AK-MSH, e pranon edhe vet ne vendimin e kërkesës për rishqyrtim se dëshmitë janë ne gjuhe te huaja dhe është mjaft sfiduese për AK-ne identifikimi i sakte i dëshmive. Sipas këtij deklarimi te AK-se nuk është bere fare vlerësimi i dëshmive për makineritë. Eksperti shqyrtues sqaron se qëndron pretendimi i OE ankues dhe njehe rit i rekomandoj AK-se, qe te përdorë dispozita e Ligjit për Prokurim Publik

dhe te sqarohen dhe vlerësohen drejte dëshmitë e dorëzuara.

Pretendimi nr. 5.

OE ankues pretendon se gjatë qasjes në dokumente zyrtare, Zyra e Prokurimit ka shkelur Ligjin e Prokurimit Publik, ku për disa Operator Ekonomik nuk na ka dhënë dokumentacion shembull: 1. Fitorja Sh.p.k 2. Ada Consulsting Group Sh.p.k.

Eksperti shqyrtues, sqaron se, OE ankues nuk ka dorëzuar prove lidhur me pretendimin se AK nuk na ka dhënë qasje ne ofertën e dy OE-ve te lartpërmendur, përderisa AK-ja ne vendimin e kërkesës për rishqyrtim ka deklaruar se nuk keni dashur ti merrni dy ofertat dhe e keni te nënshkruar procesverbalin. Prandaj, nuk qëndron ky pretendim.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Lidhur me ankesën r OE “CONEX” L.L.C., me nr. 2025/0105

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar sipas dispozitave ligjore ngase lidhur me pretendimin ankimor Pretendimi i parë (1). Në bazë të vendimit ku Autoriteti Kontraktues ka eliminuar OE ankues për Sigurimin e ofertës është kërkuar 70,000 euro me afatin e vlefshmërisë prej 150 ditë, ndërsa OE ka ofertuar me afat të vlefshmërisë prej 120 ditë, sipas NJK dhe DT - IV.3.4) A është e nevojshme siguria e tenderit: Nëse po, vlera e sigurisë së tenderit 70,000.00 euro, Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë 150 apo muaj, përderisa OE ne ofertën e tij ka ofruar sigurimin nga Kompania e Sigurimeve SIGKOS per periudhën : 18.11.2024 deri 18.03.2025, e që saktësisht sipas llogaritjeve kalendarike është vetëm 120 ditë. Bazuar në LPP- neni Neni 57 paragrafi 2 citon qartë se “Nëse autoriteti kontraktues vendos një kërkesë për sigurimin e tenderit, kërkesa e tillë do të aplikohet për të gjithë tenderuesit. Autoriteti kontraktues do të refuzojë dhe nuk do të vlerësojë një tender të pranuar nga një tenderues që nuk e ka përmbushur kushtin e depozitimit të sigurisë së tenderit”. Andaj AK me të drejtë ka aplikuar dispozitën ligjore ngase OE ankues nuk e ka përmbushur kërkesën e AK-se sipas NJK dhe DT-se.

Lidhur me Pretendimin i dytë (2): PSH konstaton se sa i përket kërkesës së parashtruar në DT: Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se ka realizuar me sukses ne tërësi projekte te

ngjashme nga lamia e punëve në objekte të larta, në vlerë të përgjithshme jo më pak se 9 Milion Euro, gjatë periudhës së shkuar tre vjeçare nga data e Njoftimit për Kontratë. Ne rast të konsorciumit, së paku 60% e projekteve kërkohet për liderin e grupit. Së paku njëri nga projektet të jetë nga objekt shëndetësorë - kontratë me vlerë të madhe e realizuar nga lideri i grupit. Paneli Shqyrtues ia fal besimin përveq dokumentacionit të dorëzuar edhe gjatë sqarimeve nga ana e AK po ashtu edhe përgjigjës së dhënë nga ana e AK lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues citat..”OE i rekomanduar vetëm me Amelia – faza 3 e kalon vlerën prej: 8 milion €, ndërsa ka të realizuara edhe projekte tjera mbi 5 milion euro, andaj si mund të kontestohet vlera e kërkuar prej 9 milion. AK-MSH gjatë vlerësimit, i ka shqyrtuar në detaje këto referenca dhe dy here ka kërkuar sqarime të OE i rekomanduar pikërisht për çështjen e referencave, andaj konsiderojmë se kjo kërkesë është e plotësuar nga OE i rekomanduar. “. PSH bazuar në këtë përgjigje dhe sqarimeve të ofruara nga AK konsideron se autoriteti kontraktues do të themelojë një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave ku të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës.

Paneli Shqyrtues po ashtu sa i përket pretendimit ankimor lidhur me stafin inxhinierik , PSH ia fal besimin përgjegjes së dhënë nga ana e AK të cilat i ka vlerësuar si *devijime minore* , ngase AK bazuar në dispozitat ligjore të nenit 59.4 të LPP-së është në diskrecionin e AK të vlerësojë devijimet e vogla, më saktësisht “*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjia, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.*”

Lidhur me ankesën e OE “BM Group” SH.P.K., me nr. 2025/0106

Paneli Shqyrtues do të lëshohet vetën në pretendimet ankimore të cilat për çka është eliminuar ky OE ankues dhe në këtë rast PSH nuk e mbështet raportin ekspertës shqyrtues ngase vet ekspertja në raportin e saj ka konstatuar se mungojnë pozicionet në Planin dinamik të ofruar dhe ato janë : gjithsej 28 pozicione të përfshira sipas kapitullit nr 5 - PREVENTIV I PUNIMEVE MNZ - "Instituti Special" MAKINERI DHE PAJISJE;5.2. FITTINGS;5.3. MAKINERI DHE PAJISJE;5.4. RRJETI I SHPERNDARJES SE TUBACIONEVE; për arsye se OE ankues në ofertën e tij nga të gjeturat në këtë procedur sipas platformës elektronike e-prokurimit konstatohet se në Planin Dinamik të ofruar sipas kërkesës së AK-se ku është kërkuar:” sipas DT Aneksi 1.

“Shenim: AK ka vendosur afatin kohor, konform normave dhe standardeve ndërtimore, si dhe ndarjeve buxhetore, ku është vlerësuar afatit për implementim të këtij projekti max. 24 muaj.

OE duhet të dorëzon me Ofertën e tij, “Planin Dinamik të Detajuar” duke plotësuar Formën Standarde të Planit Dinamik të publikuar si dokument shtese në eprokurim tek Dosja e Tenderit.

Për secilin pozicion të përshkruar në paramasë duhet të shënohet numri i ditëve të nevojshme për përfundimin e pozicionit të caktuar. Plani dinamik duhet të jetë konform normave dhe standardeve ndërtimore. “

PSH konstaton se është kërkesë e vendosur sipas asaj që: AK ka vendosur afatin kohor, konform normave dhe standardeve ndërtimore, si dhe ndarjeve buxhetore, ku pas një hulumtimi dhe analize nga ana e AK-se është vlerësuar afati për implementim të këtij projekti max. 24 muaj. Lidhur me këtë konstatim nga ana e PSH bazuar në kërkesën e AK-së. konsiderojmë se OE duhet të dorëzon me Ofertën e tij, “Planin Dinamik të Detajuar” duke plotësuar Formën Standarde të Planit Dinamik të publikuar si dokument shtese në eprokurim tek Dosja e Tenderit. Për secilin pozicion të përshkruar në paramasë duhet të shënohet numri i ditëve të nevojshme për përfundimin e pozicionit të caktuar. Plani dinamik duhet të jete konform normave dhe standardeve ndërtimore , ndersa sipas Planit Dinamik të ofruar nga ky OE ankues mungon përshkrimi i punimeve të lartëcituara, kështu që PSH sikurse edhe ekspertja shqyrtuese konstaton se Plan Dinamik i ofruar nga ankuesi, nuk është ofruar sipas kërkesës së DT - dokumentit shtojcë -Plani dinamik i dates 21.10.2024 dhe si i tillë nuk ofron të dhëna të sakta rreth implementimit të këtij projekti, përshirë edhe afatet e ekzekutimit të punëve., mirëpo PSH nuk mbështetë pjesën e raportit të ekspertës lidhur me sqarime shtesë sepse ne raste të tilla nuk mund të aplikohet neni 72 i LPP-së duke ditur se e njëjta bie ndesh me parimet bazë të prokurimit publik – ndryshimi material i dosjes i cili bie ndesh me dispozitat ligjore të nenin 59 të LPP-së paragrafi 2 citoj’’ *Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkojen ose pranohen nga autoritetikontraktues ose të ofrohen nga një tenderues’’*, andaj edhe sikurse të kthehet procedura në rivlersim nuk mund të ketë ndryshim material.

PSH nuk e mbështete përgjigjen e dhënë nga ekspertja sa i përketë pjesës së vendosur lidhur me planin dinamik ashtu që *“Operatori Ekonomik pas nënshkrimit të kontratës në kordinim me menaxherin e kontratës të Autoritetit Kontraktues, do të bëjë adaptimin e planit dinamik të dorëzuar sipas datës së planifikuar për fillimin e ekzekutimit të punëve. ...”*. Paneli Shqyrtues konstaton se kjo fjali është shumë kjashtë dhe e njëjta sqaron sa i përketë koordinimit sipas datave të planifikuara por jo asnjehërë që të bëhet ndonje ndryshim brenda planit dinamik të dorëzuar nga cilindo çoftë OE ofertues.

- Përfundim -

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët konsideron së vetëm disa nga gjetjet e ekspertës shqyrtuese dhe mendimi i saj janë të pranueshme nga ana e këtij Paneli.

Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim mes tjerash dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër. Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli vuri në zbatim mes tjerash dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër.

Rrjedhimisht, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – MINISTRIA E SHËNDETËSISË, lidhur me aktivitetin e prokurimit – “lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i objektit të ri për Institutin Special në Shtime” me numër të prokurimit 206-24-187-5-1-1.

Paneli shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional dhe po ashtu përgjegjës sipas nenit 59.1 cituar "Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës". Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Andaj, paneli shqyrtues në përputhje me Ligjin për Prokurim Publik (LPP) dhe parimet themelore të tij, Autoriteti Kontraktues (AK) ka për detyrë të sigurojë që procesi i prokurimit të jetë efikas, transparent dhe i drejtë, duke trajtuar të gjithë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese. Kjo përfshin edhe detyrimin për të garantuar përdorimin ekonomik dhe efektiv të fondeve publike, duke mos kontribuar dhe prolonguar këtë aktivitet të prokurimit. Përfundimisht, bazuar në sqarimet e mësipërme, rezulton për këtë panel se AK, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë në pajtim të plotë me dispozitat ligjore të nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht është respektuar edhe nenin 60 i LPP-së si kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm më çmimin më të ultë. Po ashtu, Paneli shqyrtues detyrohet ta marrë në konsideratë faktin parimore se duhet ti ketë parasysh edhe dispozitat e neneve 1, 6 dhe 7 të LPP-së përmbajtja e të cilave përbën fakt notor për të gjitha AK dhe OE.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si me lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË, MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - CONEX L.L.C., BM Group SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: